

**RNR në Ballkanin Perëndimor**

14/04/2022

**PUNIMI PËRFUNDIMTAR**

RNR (Rrjeti i Ndërgjegjësimit ndaj Radikalizimit) në Ballkanin Perëndimor - Punëtori rajonale profesionale me përmasa të vogla

Puna me kundërvajtës ekstremistë ose terroristë përgjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu

30 mars 2022, Online

# Puna me kundërvajtës ekstremistë ose terroristë përgjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu

## Rezultatet kryesore

Puna me kundërvajtës të dhunshëm ekstremistë ose terroristë të burgosur ose të liruar rishtas (KDHE), duke përfshirë këtu edhe luftëtarët e huaj terrorist (LHT) të kthyer, paraqet një sfidë relativisht të re për shoqëritë në Ballkanin Perëndimor. Rajoni është përballur me një sërë sfidash në lidhje me KDHE-të dhe LHT-të, duke përfshirë radikalizimin në burgje, zbatimin e masave efektive rehabilituese dhe shkëputëse në sistemin e burgjeve, mungesën e perspektivës gjinore dhe kapacitete dhe njohuri të përgjithshme të dobëta në punën me KDHE-të dhe LHT-të në sistemin e burgjeve. Megjithatë, ka një kuptim në rritje të këtyre sfidave dhe mënyrave në të cilat koordinimi, bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet autoriteteve qeveritare, institucioneve fetare, organizatave që merren me aktivitete fetare, shoqërisë civile dhe komunitetit mund ta përmirësojnë procesin e menaxhimit të daljes nga burgu të KDHE-ve dhe LHT-ve. Periudha e vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu e KDHE-ve dhe LHT-ve është e rëndësishme për ndërprerjen dhe dobësimin e potencialit të recidivizmit. Ky punim përfundimtar ofron një përmbledhje të diskutimeve nga punëtorja profesionale rajonale me përmasa të vogla "Puna me kundërvajtës të dhunshëm ekstremistë ose terroristë përgjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu" të mbajtur më 30 mars 2022. Në punëtori morën pjesë praktikues që punojnë përgjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor. Disa nga pikat kryesore të këtij seminari përfshijnë:

- **Ngurrimi i KDHE-ve për të bashkëpunuar me personelin e burgjeve dhe profesionistët e tjerë mbetet një sfidë e madhe** në rajon. Investimi në kapacitetin njerëzor është thelbësor dhe personeli i burgjeve duhet të ndjekë **trajnim të synuar** për t'u mundësuar atyre të aplikojnë qasje të individualizuara ndaj KDHE-ve, duke përfshirë mënyrën se si të ndërtojnë raporte dhe ta kuptojnë mekanikën e besimit. Kjo duhet të përfshijë intervista hetimore të bazuara në të drejtat e njeriut dhe sigurinë dinamike si mënyra për të ndërtuar një marrëdhënie pozitive profesionale me klientin. Trajnimet duhet të vlerësohen në mënyrë më sistematike për sa i përket qëndrueshmërisë dhe efektivitetit.
- **Kushtet e burgjeve** janë gjithashtu të rëndësishme për të përmirësuar marrëdhëniet e pavullnetshme me klientët – burgu duhet ta normalizojë jetën dhe të sigurojë një mjedis të shëndetshëm në të cilin kundërvajtësi fillon të shohë mundësi për rehabilitim pas lirimimit dhe do të kishte më shumë gjasa të përfshihej në programe. Në këtë kontekst, përvoja e vendeve të Ballkanit Perëndimor tregon se është i

rëndësishëm besimi i të burgosurve në besueshmërinë e programeve të riintegritit dhe deradikalizimit. Kjo do të thotë se të burgosurit duhet të kenë besimin se programet e tilla janë me të vërtetë aty për t'i mbështetur ata.

- **Kontaktimi i anëtarëve të familjeve të KDHE-ve dhe ofrimi i mbështetjes për ta** (edukative, socio-ekonomike, mjekësore, shëndetin mendor) ka rezultuar të jetë shumë efektive në fitimin e besimit, duke i dhënë përparësi hapave konkretë për periudhën e pas liritit dhe përgatitjes për kthimin në komunitet. Kjo mund të jetë identifikimi i një personi nga familja që është i besueshëm dhe i dobishëm për procesin e rehabilitimit të KDHE-së, dhe ofrimi i mbështetjes për ta. Është po aq e rëndësishme që **të punohet me komunitetet për t'i përgatitur ato për riintegrimin e KDHE-ve të liruar**, duke përfshirë fuqizimin e OSHC-ve për të marrë përsipër këtë punë. Komunikimi është i rëndësishëm – praktikuesit duhet të shmangin të qenit 'impnoves', dhe përkundrazi duhet të demonstrojnë se janë aty për të ndihmuar.
- Ekziston një nevojë e qartë për të **kaluar hendekun midis personelit të sigurisë që punon me KDHE-të në burg dhe praktikuesve që ofrojnë trajtim në fazën pas liritit nga burgu**. Punonjësit socialë dhe psikologët duhet të lejohen të kontaktojnë me KDHE-të ndërsa janë ende në burg, si pjesë e përgatitjes për lirim. Burgjet nuk duhet të lihen vetëm në përgjegjësinë për KDHE-të, por duhet të hapen edhe për profesionistët e tjerë që ofrojnë trajtim dhe mbështetje.

## Çështjet kyçe të diskutimit

### Burgjet në Ballkanin Perëndimor ende mësojnë se si të merren me KDHE-të dhe LHT-të

KDHE-të dhe LHT-të janë një fenomen relativisht i ri për burgjet në Ballkanin Perëndimor dhe për këtë arsye sistemi ende po mëson dhe përshtatet për t'u përballur me sfidat që i paraqesin ata. Kjo rezultoi me atë që burgjet u bënë të cenueshme ndaj radikalizimit. Autoritetet qeveritare në Ballkanin Perëndimor e kuptojnë se qasja që "është e përshtatshme për të gjithë" thjesht nuk funksionon për sa i përket periudhës së vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu të KDHE-ve dhe LHT-ve. Për shembull, në Kosovë\* shërbimi korrektues filloi ta trajtojë personelin e tij për trajtimin e KDHE-ve dhe LHT-ve dhe të zhvillojë një program rehabilitimi dhe risocializimi në vitin 2016. Prandaj, ka sfida me mungesën e kapaciteteve, dhe në disa raste edhe burime të pamjaftueshme për t'u marrë me KDHE-të dhe LHT-të në burg dhe pas liritit të tyre. Personeli në sistemin e burgjeve është, në thelb, i trajnuar për t'iu qasur punës së tyre në aspektin e sigurisë dhe shpesh ka mungesë të aftësive dhe njohurive të nevojshme për të kryer detyra komplekse siç është vlerësimi i shkallës së radikalizimit dhe përkushtimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm të KDHE-ve dhe LHT-ve. Përveç kësaj, KDHE-të dhe LHT-të janë, në esencë, dyshues dhe jo-bashkëpunues me institucionet shtetërore, gjatë dhe pas periudhës së paraburgimit. Angazhimi më i fortë me komunitetin dhe familjet e KDHE-ve dhe LHT-ve, si dhe përpjekjet e përbashkëta me shoqërinë civile mund të ndihmojnë në përmirësimin e situatës.

Masat e ndërtimit të besimit ndërmjet KDHE-ve/LHT-ve në sistemin e burgjeve dhe personelit të caktuar për të punuar në deradikalizimin dhe rehabilitimin janë thelbësore. Ndryshimet e shpeshta të personelit në sistemin e burgjeve paraqesin një sfidë për të ndërtuar besimin me KDHE-të dhe LHT-të. Është thelbësore që zyrtarëve korrektues t'u jepet më shumë kohë për ta kuptuar dinamikën dhe për të ndërtuar një raport me KDHE-të dhe LHT-të, gjë që mund të çojë në një shkallë më të lartë pjesëmarrjeje në programet e deradikalizimit dhe rehabilitimit, si dhe në një qasje më konstruktive dhe bashkëpunuese me institucionet publike pas liritit nga burgu. Në përgjithësi, kushtet në burgjet në Ballkanin Perëndimor duhet të jenë të favorshme për përmbushjen e qëllimit të rehabilitimit dhe deradikalizimit.

### Qasjeve për trajtimin e KDHE-ve dhe LHT-ve u mungon një perspektivë e duhur gjinore

Ka shumë pak raste të grave KDHEt të dënuara, sepse qasja e përgjithshme ka qenë që gratë e kthyer të mos ndiqen penalisht. Në Kosovë, gratë e kthyer nuk janë marrë në pyetje menjëherë pas mbërritjes së tyre, mirëpo ato nuk i kanë shpëtuar ndjekjes penale. Vlerësohet se rreth 20 gra të kthyer janë akuzuar në Kosovë, dhe 16 e kanë pranuar fajin për akuzat si "organizimi dhe pjesëmarrja në një grup terrorist".

Megjithatë, në një perspektivë më të gjerë të P-KEDH, aplikimi i një qasjeje të ndjeshme gjinore është thelbësor në sigurimin e programeve efikase të shkëputjes dhe riintegrit. Kjo gjithashtu e forcon bashkëpunimin midis shumë agjencive dhe kontribuon në ndërtimin e besimit ndërmjet institucioneve dhe KDHEt-ve. Rastet e Shqipërisë dhe të Bosnje dhe Hercegovinës e nxjerrin në pah këtë çështje. Bazuar në përvojën e praktikantëve në punëtori, programet në Shqipëri u drejtohen kryesisht meshkujve dhe ka mungesë njohurish se si duhet të jetë qasja ndaj grave KDHEt dhe LHT. Pjesëmarrësit në punëtori e kanë theksuar rëndësinë e mbështetjes socio-ekonomike pas lëshimit nga burgu të KDHEt-ve/LHT-ve, së bashku me programet e specializuara për mbështetjen e grave dhe fëmijëve, duke përfshirë edukimin dhe sigurimin e mbështetjes adekuate për shëndetin mendor. Përvojat nga BdeH tregojnë se disa gra të kthyer të lidhura me KDHEt-të shpesh janë të varura ekonomikisht dhe vazhdojnë t'i mbështesin ata. Prandaj, mungesa e programeve specifike të risocializimit për këto gra kontribuon në thellimin e mosbesimit të KDHEt-ve dhe familjeve të tyre ndaj institucioneve publike në përgjithësi.

### **Rëndësia e bashkëpunimit, koordinimit dhe komunikimit për periudhën gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu**

Bashkëpunimi, koordinimi dhe komunikimi ndërmjet autoriteteve qeveritare në kontekstin e menaxhimit të periudhës pas daljes nga burgu të KDHEt-ve dhe LHT-ve është thelbësor. Kjo do të thotë se institucionet publike që janë përgjegjëse për monitorimin dhe trajtimin e KDHEt-ve dhe LHT-ve pas daljes së tyre nga burgu varen nga informacioni cilësor nga personeli i burgut në lidhje me individët përkatës. Megjithëse kjo është përmirësuar me përvojën e fituar, rëndësia për të forcuar transferimin e metodave, njohurive dhe qasjeve në mjediset me shumë agjenci vazhdon të jetë e pranishme. Në këtë drejtim, nevojitet një bashkëpunim i zgjeruar ndërmjet shërbimeve sociale, institucioneve të sigurisë dhe komuniteteve lokale për të sqaruar se çfarë informacioni duhet të ndahet dhe në çfarë mase aktorët jointucionalë janë të kufizuar në punën me KDHEt-të, pa e cenuar sigurinë.

Sfidat dhe përvojat kryesore me përgatitjen e KDHEt-ve për lirim dhe në fazën pas lirimit që u diskutuan gjatë takimit përfshijnë:

- mungesën e çfarëdo **komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet shërbimeve sociale, personelit të sigurisë dhe të burgjeve dhe komuniteteve** në fazat e hershme të kthimeve dhe dënimeve të LHT-ve, ndërkohë që disa sfida vazhdojnë.
  - Në Bosnje dhe Hercegovinë, për shembull, shërbimet sociale duhej të punonin me agjencitë e sigurisë për herë të parë dhe ishte e vështirë të gjendej një bazë e përbashkët.
  - Institucionet dhe praktikuesit që merren me periudhën gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu (p.sh., qendrat e mirëqenies sociale) duhet të kenë qasje në informacione cilësore ose inteligjencë nga sistemi i burgjeve në lidhje me KDHEt-të dhe LHT-të që lirohen. Për shembull, në rastin e Kosovës, ka shqetësime se raportet që përgatiten për KDHEt-të dhe LHT-të pas lëshimit të tyre ka prirje të jenë gjenerike, pa informacion të detajuar për individin përkatës, gjë që mund t'i pengojë përpjekjet e institucioneve për të planifikuar në mënyrë efektive mbështetje për individët përkatës.
- Në Kosovë\*, Divizioni për Parandalimin dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar (DPR) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga Shërbimet Korrektuese të Kosovës (SHKK) merr informacion përmes e-mailit dhe një plan individual për çdo LHT të burgosur 3 muaj para lirimit të tyre. Gjithashtu, stafi i DPR-së ka qasje në bazën e të dhënave të SHKK-së të LHT-ve. Ky është një **shembull i një mekanizmi për shkëmbimin e informacionit dhe strukturave që ekzistojnë për të mundësuar komunikimin.**

- Mbështetja ekonomike për KDHE-të dhe LHT-të nga institucionet publike dhe shoqëria civile konsiderohet thelbësore për ndërtimin e besimit, megjithatë sfidat në komunikimin ndërmjet institucioneve, si dhe ndërmjet institucioneve dhe KDHE-të dhe LHT-të, kanë krijuar herë pas here **pritsmëri dhe perceptim jorealit të nevojave**.
- **Masat përcjellëse pas lirit nga burgu.** Nuk ka programe të veçanta në të cilat KDHE-të dhe LHT-të mund të kenë qasje pas periudhës së paraburgimit në Ballkanin Perëndimor, por ata inkurajohen të kenë qasje në programet ekzistuese të mirëqenies sociale për punësim dhe ndihmë sociale. Megjithatë, këto shpesh janë të kufizuara në kohë dhe shtrirje. Procedurat administrative dhe kriteret e bëjnë më të komplikuar qasjen në programe të tilla për KDHE-të dhe LHT-të.
  - Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë, përgatitja për lirim të KDHE-të fillon vetëm tetë ditë përpara lirit aktual. Në disa raste, KDHE-të mund të përdorin masat e përgjithshme të mirëqenies sociale pas lirit, por vetëm për një muaj. Ky kufizim kohor është gjithashtu i pamjaftueshëm për të përgatitur profesionistët të cilët do të ofrojnë ndonjë mbështetje dhe trajtim pas lirit. Ky është shpesh kontakti i parë ndërmjet KDHE-të dhe shërbimeve sociale, ku shpeshherë këtyre të fundit u mungojnë trajnimet e duhura për t'u marrë me raste të tilla të ndjeshme.
  - Stereotipet gjinore duket se ndikojnë gjithashtu në periudhën pas daljes nga burgu, si p.sh. kur KDHE-të meshkuj hezitojnë të punojnë me punonjëse sociale femra.
  - Një sfidë e qartë lidhet me KDHE-të e lëshuar në komunitete të vogla dhe/ose rurale ku praktikuesit nuk kanë marrë trajnime dhe nuk ka mbështetje.
- **Zgjidhjet** e mundshme të diskutuara për sfidat e identifikuar përfshijnë:
  - Kontaktimin me familjet përpara lirit për të ndërtuar besim dhe për të ofruar mbështetje socio-ekonomike.
  - Lejimin e punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë (të tillë si punonjësit e shëndetit mendor) për të kontaktuar me KDHE-të që në burg.
  - Pjesëmarrësit theksuan se bashkëpunimi dhe komunikimi me liderët fetarë dhe organizatat që merren me aktivitete fetare është kyç për trajtimin e KDHE-të dhe LHT-të pas daljes nga burgu.
- **Menaxhimi i rasteve i vendosur për riintegrimin e grave dhe fëmijëve** të kthyer mund të përdoret më tej kur KDHE-të lëshohen në komunitete për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet agjencive të shumta. Masat e riintegrit për familjet (si mbështetja për fillimin e një biznesi) mund të zbatohen më tej.

## Rekomandime

### 1. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të burgut dhe zyrtarëve të tjerë përkatës në periudhën pas daljes nga burgu përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe menaxhimit të njohurive.

- Trajnime janë të nevojshme për personelin ekzistues, por edhe punësimi i ekspertëve të kualifikuar dhe profesionistëve në burgje. Plan-programet e trajnimeve për personelin e burgjeve dhe të provës duhet të përditësohen rregullisht.
- Për më tepër, ekziston nevoja për të krijuar mundësi më sistematike për shkëmbimin e përvojës në trajtimin e KDHE-të dhe LHT-të ndërmjet personelit të burgjeve dhe zyrtarëve publikë nga Ballkani Perëndimor.
- Po aq e rëndësishme për sa i përket ngritjes së kapaciteteve është që autoritetet qeveritare në Ballkanin Perëndimor të përmirësojnë procesin e dokumentimit dhe mbledhjes së metodave, qasjeve, aktiviteteve

që lidhen me trajtimin e KDHE-ve dhe LHT-ve, dhe të mundësojnë ndarjen dhe përdorimin e një informacioni të tillë për administratën dhe shoqërinë civile. Me fjalë të tjera, sistemi i burgjeve duhet të jetë në gjendje të ofrojë informacion cilësor për institucionet publike, (d.t.th., qendrat e mirëqenies sociale, policinë lokale), mbi KDHE-të dhe LHT-të që lirohen nga burgu. Një informacion i tillë është i rëndësishëm për të planifikuar masat e duhura për të mbështetur rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Burgjet/Shërbimet Korrektuese duhet të zhvillojnë mjete përmes të cilave punonjësit socialë dhe profesionistët e tjerë (duke përfshirë punonjësit e shëndetit mendor) mund të kontaktojnë me KDHE-të dhe LHT-të përderisa janë në sistemin e burgjeve. Kjo potencialisht do të çonte në një kuptim më të mirë nga ana e institucioneve që punojnë në procesin e riintegrit me KDHE-të dhe LHT-të për nevojat e tyre dhe llojin e qasjeve që do të ishin më efektive në mbështetjen e rehabilitimit dhe riintegrit të tyre.

## 2. Zhvillimi i programeve të përshtatura për t'u marrë me KDHE-të dhe LHT-të, të cilat gjithashtu e përmirësojnë mbështetjen ekonomike për ta

- Mbështetja socio-ekonomike për KDHE-të dhe LHT-të pas daljes nga burgu shihet si një masë e rëndësishme për ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit ndaj radikalizimit dhe ndërtimin e besimit në institucionet publike. KDHE-të duhet të marrin ndihmë socio-ekonomike dhe praktikuesit duhet të punojnë në rritjen e mundësive të punësimit të KDHE-ve pas lirimit të tyre. Sipas kësaj, perceptimi publik për një lloj mbështetjeje të tillë është i rëndësishëm.
- Rritja e mbështetjes për Qendrat e Mirëqenies Sociale për përfshirje më efektive në procesin e riintegrit të të kthyerve në shoqëri. Një mbështetje e tillë duhet të përfshijë edhe më shumë burime edhe zhvillimin e kapaciteteve. Zhvillimi i mëtejshëm i mekanizmave ekzistues të punës në menaxhimin e rasteve të grave dhe fëmijëve të kthyer.

## 3. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shtetit, aktorëve të shoqërisë civile si dhe institucioneve fetare

- Bashkëpunimi i më shumë agjencive duhet të ndërtohet mbi një strategji komunikimi që e promovon vlerësimin e përbashkët dhe ndërgjegjësimin ndërmjet institucioneve të ndryshme, OSHC-ve dhe komunitetit në përgjithësi. Kjo do të mundësonte qartësimin e mëtejshëm të roleve të aktorëve të sigurisë dhe jo-sigurisë në shkëputjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e proceseve të KDHE-ve.
- Roli i aktorëve të ndryshëm joqeveritarë që luajnë një rol pas lirimit, si p.sh. liderët fetarë, anëtarët e familjes së KDHE-ve, udhëheqësit e komunitetit dhe praktikuesit e tjerë, duhet të integrohet në planifikimin e bashkëpunimit të më shumë agjencive dhe planifikimin e ndërhyrjes, duke përfshirë sigurimin e një periudhe të qëndrueshme pas daljes nga burgu.
- Të konsolidohet një shkëmbim dhe bashkëpunim i qëndrueshëm dhe sistematik i informacionit midis të gjithë aktorëve të përfshirë.
- Boshllëqet në kapacitetet e aktorëve të përfshirë në qasjet e përbashkëta të shkëputjes, rehabilitimit dhe riintegrit duhet të hartëzohen dhe të adresohen herët, për shembull nëpërmjet trajnimeve, për të siguruar që ndërhyrjet e tyre janë reciprokisht efektive. Vlerësimi i përbashkët është një tjetër mjet kyç për të ndërtuar efektivitetin e ndërhyrjeve bashkëpunuese.

## Praktikat përkatëse

1. Përvoja e BdeH-së tregon se Qendrat e Mirëqenies Sociale janë një mekanizëm instrumental për trajtimin e KDHE-ve dhe LHT-ve pas lirimit nga burgu dhe lehtësimin e riintegrit të tyre në shoqëri. Këto qendra përfaqësojnë një praktikë të mirë në zhvillim e sipër të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë dhe atyre jo të sigurisë.
2. Në Kosovë, [Divizioni për Parandalimin dhe Riintegrimin e Personave të Radikalizuar](#) (DPRPR) është një divizion qeveritar që ka krijuar marrëdhënie të mira me komunitetin dhe kjo ka luajtur një rol kyç në riintegrimin e kosovarëve të riatdhesuar nga Siria dhe Iraku. Parimi i një përvoje të tillë mund të

zbatohet plotësisht edhe në trajtimin e të burgosurve ekstremistë të liruar.

3. Nisma rajonale '[Rritja e kapaciteteve të burgjeve në adresimin e radikalizimit në burgjet në Ballkanin Perëndimor](#)' i financuar nga Komisioni Evropian dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës synon të kapërcejë boshllëqet në kapacitetet për parandalimin terciar dhe të përmirësojë menaxhimin e burgjeve në rajon. Ajo fokusohet në trajnimin e personelit të burgjeve dhe të provës, qasjet e rehabilitimit, përgatitjen për lirim dhe ndihmën pas dënimit.

## Aktivitetet e mëtejshme

Së pari, diskutimi në punëtori sugjeron që autoritetet qeveritare në Ballkanin Perëndimor do të përfitonin nga një punëtori mbi bashkëpunimin dhe koordinimin midis organizatave të shoqërisë civile, komunitetit dhe institucioneve publike në monitorimin dhe menaxhimin e periudhës gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas daljes nga burgu të KDHE-ve dhe LHT-ve. Së dyti, do të ishte e dobishme një punëtori që mundëson shkëmbimin e përvojës ndërmjet institucioneve publike në rajon në trajtimin e KDHE-ve dhe LHT-ve pas daljes nga burgu, duke përfshirë personelin e burgut. Së fundi, në një perspektivë më të gjerë të P-KEDH, autoritetet qeveritare në rajon mund të përfitojnë gjithashtu nga një punëtori mbi perspektivën gjinore dhe bashkëpunimin me sektorin privat për riintegrimin e KDHE-ve dhe LHT-ve, duke përfshirë të burgosurit e liruar.

## Materiale për lexim

**HF II Rajonal - Rritja e kapaciteteve të burgjeve në adresimin e radikalizimit në burgje** "Qëllimi kryesor i Veprimit është të rrisë sigurinë rajonale duke përmirësuar shkëmbimin ndërinstitucional të njohurive dhe praktikave të mira në rajon në lidhje me radikalizimin në burgje, me synimin për t'i ofruar stafit të sistemit të burgjeve standardet, mjetet dhe instrumentet e nevojshme për të reaguar në mënyrë të duhur.

**Vlerësimi bazë për Shërbimin Sprovues të Kosovës** nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ofron një vlerësim bazë të sfidave me të cilat përballlet Shërbimi Sprovues i Kosovës në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e KDHE-ve dhe LHT-ve. Raporti bazohet në intervistat personale me personelin e Shërbimit Sprovues të Kosovës, duke ofruar kështu një pasqyrë të rëndësishme në sfidat e përditshme të individëve që merren me KDHE-të dhe LHT-të.

**Promovimi i një qasjeje me shumë palë të interesuara për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm**: Raport përmbledhës i diskutimeve në tryezën e rrumbullakët për Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Raporti e potencon sfidën me mungesën e kapaciteteve dhe njohurive se si të menaxhohet dalja nga burgu i KDHE-ve dhe LHT-ve në mënyrë që të parandalohet recidivizmi.

*\*Ky kategorizim është pa paragjykim për pozitat lidhur me statusin, dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Mendimin e GjND-së për deklaratën për pavarësinë e Kosovës*